

SCC – 08 – 0091

Komuna e Pejës

E përfaqësuar nga

*Paditës*

vs.

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, e përfaqësuar nga UNMIK-u,  
TSS, Prishtinë

*E paditura*

Trupi Gjykses i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, i përbërë prej Laura Plesa, Gjyqtare Kryesuese, Anna Bednarek dhe Sabri Halili, Gjyqtarë, pas seancës vendim-marrëse të mbajtur më 14 janar 2011 lëshon këtë:

### AKTGJYKIM NË MUNGESË

1. Padia e Komunës së Pejës kundër Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit hedhet poshtë.

#### Rrethanat procedurale

Me 14 prill 2008, paditësi: Komuna e Pejës ka paraqitur padi pran Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit duke kërkuar certifikimin e saj si pronare e ngastrave kadastrale me numra: 1014, 1076, 1077, 1078, 1127, 4098, 4099, 4100/1, 4100/2, 4420, 4422/11, 4428/3, 4444/3, 4475/8, 4498/3, 4498/64502/1, 4502/2, 4558/2, 4559/3, 4560/2, 4560/4, 4565/1, 4569, 4570/4, 4571/1, 4618/1, 4618/2, 4624/4, 4626/5, të gjitha këto në fletën poseduese nr. 21, zona kadastrale Pejë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 39.51,54 ha. Paditësi ka shpjeguar se ai është pronar i pronës së paluajtshme e cila ishte regjistruar si pronë shoqërore në emër të Organizatës Bazë të Bunës së Bashkuar (OTHPB) [REDAKTUAR] me seli në Pejë. Komuna ka shpjeguar se ndërmarrjet shoqërore apo publike kanë patur të drejtën që ti shfrytëzojnë ato ngastra. Njëra nga këto ka qenë edhe [REDAKTUAR], Paditësi nënvizon se kjo organizatë iu kishte nënshtruar falimentimit me 15 dhjetor 1997 dhe se procedura e falimentimit ishte udhëhequr nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë me numër të lëndës St. 142/1993. Si rezultat i kësaj procedure, paditësi thotë, së Fabrika e Sheqerit ishte çregjistruar nga regjistri i

personave juridik. Sipas mendimit të komunës, e paditura nuk mund ta administroi pronën e një personi juridik që nuk ekziston dhe nuk mund të trajtohet si pronar i pronës së regjistruar më parë në emër të një organizatës së mëhershme. Paditësi po ashtu ka cekur se sipas Nenit 206, paragrafi 3 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar (G. Z. e SFRJ Nr 53/76 dhe Nr 85/87), nëse toka nuk është nën administrimin e punëtorëve apo nuk është pronë e personave fizik, toka duhet të administrohet nga Komunitat, në territorin e së cilave gjendet toka. Kjo dispozitë zbatohet në lëndën konkrete në bazë të Nenit 197 të Ligjit mbi Ndërmarrjet (G. Z. e SFRJ Nr 77/88.

Në të njëjtën kohë, paditësi ka kërkuar caktimin e masës paraprake të parandalimit dhe që Agjencia Kosovare e Mirëbesimit të ndalohet nga privatizimi i ngastrave të përshkruara në padi.

Komuna ia ka bashkangjitur padisë:

1. autorizimin mbi akreditimit të avokatit [REDAKTUAR] + përkthimin në Anglisht;
2. njoftimin dhënë Agjencisë mbi synimin për të paraqitur padi të datës 1.04.2008 + përkthimin në Anglisht;
3. letrën nga Kryetari i GJEQ në Prishtinë të datës 7.09.2007 + përkthimin në Anglisht.

Me 17 prill 2008, Dhoma e Posaçme ia dërguar të paditurës padinë dhe kërkesën për masë parandaluese.. AKM e ka pranuar urdhrin në të njëjtën ditë.

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit e ka paraqitur një përgjigje në kërkesën për masë parandaluese me 18 prill 2008. Sipas të paditurës paditësi nuk i ka siguruar faktet dhe arsyet të cilat do ta justifikonin perceptimin se Komuna do të mund ta fitonte kontestin. Për më tepër, AKM ka treguar se Komunitat nuk i kanë gëzuar “ të gjitha elementet e së drejtës së pronësisë mbi pronën shoqërore”. Ajo ka theksuar se të drejtat e komunave mbi pronën shoqërore kanë qenë të kufizuara në të drejtën për shfrytëzim, edhe kur komunitat e kanë fituar pronën e tillë për nevojat e tyre. Në bazë të ligjit të asaj kohe, komunitat kanë qenë organe administruuese të cilat kanë vendosur mbi përcaktimin e të drejtën në shfrytëzim për pronën shoqërore. Sipas mendimit të AKM-së, paditësi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi se ai do të pësonte ndonjë dëm, humbje apo lëndim të menjëhershëm dhe të pandreqshëm, nëse masa parandaluese nuk do të caktohej. Në rast se paditësi do të fitonte, ai mund ta kërkojë kompensimin e duhur. Duke konkluduar se AKM ka kërkuar që kërkesa të refuzohet.

Me 22 prill 2008, Dhoma e Posaçme e ka lëshuar një vendim në bazë të së cilit kërkesa për masë parandaluese ishte refuzuar si e papranueshme..

E paditura ka dërguar mbrojtje me 16 maj 2008. AKM ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme që ta hedh poshtë padinë sepse ajo nuk ka bazë ligjore. Ajo ka argumentuar se Agjencia ka kompetencë që të administroi asetet e Fabrikës së Sheqerit më bazë të Nenit 5.1 (a) I dhe ii dhe Nenit 6 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/18. Ajo ka shtuar se në fakt, pas vitit 1989, si rezultat i mungesës së investimeve financiare dhe për shkak të sigurisë në Kosovë, [REDAKTUAR] nuk e ishte rifilluar prodhimtarinë. AKM ka pranuar se ajo ka prova që në vitin 1993 [REDAKTUAR] ishte vënë në likuidim dhe në njëfarë forme e likuidimit të ndërmarrjes ishte kryer. Sa i përket likuidimit të tanishëm, e paditura shpjegon, se ajo ka shumë pak dokumente. Për më tepër, AKM ka dërguar një kopje të kontratës të nënshkruar

me 10 gusht 1999, në Pejë, në bazë të se cilës asetet e NSH [REDACTED] janë transferuar në NP "[REDACTED]" në Pejë.

Me 22 maj 2008, Dhoma e Posaçme ia ka dërguar paditësit mbrojtjen i cili e ka pranuar atë me 26.05.2008.

Me 20 qershor 2008 paditësi ka dërguar përgjigje me shtojcë që formulonte njoftimin mbi likuidimin e NSH [REDACTED].

Për faktin se Agjencia Kosovare e Mirëbesimit e ka ndërprerë funksionimin e saj me 31 korrik 2008, Dhoma e Posaçme e ka pezulluar procedurën në këtë lëndë.

Me aktvendimin e Dhomës së Posaçme të datës 4 shkurt 2010, pezullimi i procedurës është hequr.

Në të njëjtën ditë, Dhoma e Posaçme ka lëshuar një urdhër duke kërkuar nga paditësi që ta dërgoi përkthimin kompetent në Anglisht të përgjigjes dhe të dokumentacionit mbështetës.

Me 3 mars 2010, paditësi iu ka përgjigjur urdhrorit dhe ka dërguar përkthimin e kërkuar dhe ia ka bashkangjitur njoftimin drejtuar Gjykatës Komunale rreth likuidimit të NSH "[REDACTED]".

Me 2 dhjetor 2010, Dhoma e Posaçme ia ka dërguar të paditurës përgjigjen dhe parashtesën e paditësit të datës 8 mars 2010 së bashku me dokumentacionin mbështetës

Dhoma e Posaçme e ka caktuar një seancë për datën 9 dhjetor 2010. Përfaqësuesit të paditësit iu kishte dorëzuar ftesa në mënyrë të rregullt me 4 nëntor 2010, por nuk është paraqitur. E paditura ka qenë prezent në seancë dhe ka paraqitur kërkesë për aktvendim në mungesë.

#### Arsyetimi ligjor:

Neni 52.2 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 përcakton: "Nëse paditësi i frutuar në mënyrë të rregullt nuk paraqitet në seancë apo në një mënyrë e braktisë procedurën, Dhoma e Posaçme me kërkesë të paditues mund të bien vendim në mungesë duke e hedhur poshtë padinë dhe duke e urdhëruar paditësin që ti paguan shpenzimet e procedurës.

Duka marrë parasysh se paditësi i ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e caktuar nuk është paraqitur në gjykatë, e as që e ka informuar Dhomën e Posaçme paraprakisht për rrethanat të cilat ia kanë pamundësuar prezencën e tij në seancë, dhe duka marrë parasysh kërkesën e të paditues për të marrë vendim në mungesë, Dhoma e Posaçme vlerëson se kushtet e Nenit 52.2 të cituara më lart janë plotësuar.

Gjykata me supozim ka konkluduar se qëndrimi i palës e cila nuk paraqitet në seancën e caktuar për shqyrtimin e padisë së paraqitur duhet kuptuar si shprehje e synimit të tij që ta braktis procedurën.

Meqë dispozita e cituar më lart sugjeron që Dhoma e Posaçme në një rast të tillë bjen vendim në mungese duke e hedhur poshtë padinë, prandaj edhe është vendosur si në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

Shpenzimet:

Në bazë të nenit 12 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore paditësi lirohet nga pagesa e taksave gjyqësore.

Këshilla Ligjore:

Në kuptim të Nenit 53.1 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, “Secila palë kundër së cilës është marrë aktgjykimi në mungesë mund të paraqes kërkesë pranë Dhomës së Posaçme që ta anuloi aktgjykimin në mungesë”. Kërkesa e tillë, konform Nenit 53.2 mund të bëhet Brenda një muaji nga data e dorëzimit të aktgjykimit në mungesë të e paditura.

Laura Plesa  
Gjyqtare Kryesuese EULEX

(Nënshkruar)

Anna Bednarek  
Gjyqtare EULEX

(Nënshkruar)

Sabri Halili  
Gjyqtar

(Nënshkruar)

Tobias Lapke  
Regjistruer EULEX

(Nënshkruar)